



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 5 pika d të Ligjit NR. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 30 e datës 15 qershor 2008, nenit 14 të Rregullores (QRK) Nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësuesve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e 8-të datës 31.07.2026, të miratojë këtë :

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS AD.HOC PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORËVE DHE ZËVENDËSDREJTORËVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE EDUKATIVO ARSIMORE TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Formimi i komisionit përzgjedhës

Me këtë Vendim, formohet Komisioni Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore në Komunën e Lipjanit për konkurset për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve sipas kërkesës së Drejtorit të DKA-Lipjan nr.01-111/01-32467 të datës 14.07.2026, në përbërje si vijon:

1. Ibrahim Duriqi, DKA, Kryesues
2. Edita Bajrami, eksperte e arsimit, anëtare dhe
3. _____ Caktohet nga MASHT, anëtar

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i Komisionit përzgjedhës

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit përzgjedhës janë përzgjedhja e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të IEAAP, duke shikuar dokumentacionin e të gjithë kandidatëve që kanë aplikuar, të intervistojë dhe vlerësoj me pikë kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe kriteret sipas procedurave të Rregullores (QRK) Nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (ieaa) të arsimit parauniversitar.

2. Mandati i anëtarëve është i përkohshëm ad.hoc dhe vlenë vetëm për konkursset për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në:

- Drejtor në SHFMU "Ismail Luma" në Lipjan
- Drejtor në SHFMU "Rexhep Akllapi" në Akllap
- Drejtor në SHFMU "7 Marsi" në Poturovc
- Drejtor në SHFMU "Mixheni" Rufe i Ri
- Drejtor në SHFMU "Nezë Bujani" në Bujan
- Drejtor në SHFMU "Fehmi Agani" në Medvec
- Drejtor në SHML Gjinnazi "Ulpiana" në Lipjan
- Drejtor në SHMLM "Shaqir Hoxha" në Shalë
- Zëvendësdrejtorë në SHML Gjinnazi "Ulpiana" në Lipjan

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Arsyetim

Nr. 020/04-36634

Lipjan, më 31.07.2026

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

Daut Azemi